



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2022:153199  
Datë: 27.12.2022  
Numri i dokumentit: 03800241

ARJ nr. 114/2022

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar i kolegjit, Nebojša Boričić dhe Fejzullah Rexhepi, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, Sh.Z. F., nga Gjilani, sipas autorizimit e përfaqëson avokat, Flakron Sylejmani nga Prishtina, kundër të paditurit, Këshilli Prokurorial i Kosovës,(KPK), me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimeve të paditurit dhe kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtëve, duke vendosur sipas kërkesës së paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA. Nr.650/2022 të datës 01.09.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23 Dhjetor 2022, merr:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor e parashtruar nga paditësi, Sh.F., kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA. Nr.650/2022 të datës 01.09.2022.

**A r s y e t i m i**

Me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, AA. Nr.650/2022 të datës 01.09.2022, refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit Sh.F., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A nr. 1875/2022 i datës 02.08.2022, vërtetohet.

Kundër aktvendimit të lartë cekur të Gjykatës së Apelit, i autorizuari i paditësit avokat Flakron Sylejmani në afat ligjor në Gjykatë Supreme parashtron kërkesë për rishqyrtim të

jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të; shkeljes të drejtës materiale dhe për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, me propozim, të aprovohet si e bazuar kërkesa e paditësit ndaj aktvendimit të Gjykatës së Apelit AA nr.652/22 të datës 01.09.2022, të anulohen aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë A nr. 1875/22 i dt. 02.08.2022 dhe aktvendimi i shkallës së dytë si më lartë, dhe kjo çështje juridike ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në kërkesë ka paraqitur i padituri KPK, duke i propozuar gjykatës që kërkesa e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të refuzohet, ndërsa të vërtetohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, A nr. 1875/2022 i datës 02.08.2022 dhe aktvendimi Gjykatës së Apelit, AA. Nr. 650/2022, i dt. 01.09.2022.

Gjykata Supreme në bazë të nenit 53 të LKA, ka mbajtur seancën e kolegjit, dhe pas vlerësimit të aktvendimit të atakuar dhe atij të shkallë së parë, kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, përgjigjes në kërkesë të KPK, dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës, gjen se;

Kërkesa e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshme të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se, paditësi në Gjykatë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datë 28.07.2022, ka ushtruar padi kundër të paditurit KPK, për anulimin e akteve administrative-vendimeve të paditurit, me kërkesë padi që të njëjtit të anulohen si jo të drejtë dhe ligjor, po ashtu ka paraqitur edhe propozim për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtëve deri në vendosjen meritore të çështjes me vendim përfundimtar gjyqësor.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, A nr. 1875/2022 të datës 02.08.2022, e Hedhë Poshtë si e paraqitur pas kalimit të afatit padinë dhe propozimin e paditësit, e paraqitur në gjykatë me datë 28.07.2022, për inicimin e konfliktit administrativ, për anulimin e Vendimeve të paditurës, KPK, të dt. 06.04.2022 me të cilin z. B.I., është propozuar për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit, dhe vendimit të KPK, nr. 474/2022, për refuzimin e raportit të Komisionit për Rishqyrtim, me propozim që të bëhet shtyrja e ekzekutimit të të dy vendimeve, me numër dhe datë të cekura më lartë, deri në vendosjen e kësaj çështje me vendim përfundimtar gjyqësor.

Në arsyetim gjykata e shkallës së parë mes tjerash arsyeton; gjat shqyrtimit paraprak të padisë lidhur me rregullsinë dhe afatshmërisë e saj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Konflikte Administrative,(LKA), nenit 26 dhe 27, gjen se, paditësi vendimet e të paditurës të KPK, të cekur si më lartë, i kishte pranur përkatësisht për të njëjtit ishte njoftuar po të njëjtën datë që janë marrë, pra me datë 06 Prill 2022, prandaj bazuar në dispozitat e cekura si më lartë rezulton se afati i fundit për t'u drejtuar kësaj gjykate me padi për inicimin e konfliktit administrativ ishte deri me datë 06 Maj 2022, gjer sa paditësi ushtron padi me datë me datë 28 Korrik 2022, përkatësisht 3 muaj e 22 ditë, pas pranimit të akteve të cekura, apo 2 muaj e 22 ditë pas kalimit të afatit, ashtu si parashihet me nenin 27.1 të LKA. Pretendimet e paditësit se gjykata duhet ta konsideroj si të afatshme padinë pasi që me kohë i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese pa e ditur se kësaj radhe kjo gjykatë do të veprojnë ndryshe nga rastet e më hershme, gjykata e shkallës

së parë i refuzon me arsyetim se, Gjykata Kushtetuese ka vendosur me Aktvendim për pa pranueshmëri nr.ref.RK 2027/22 dt. 25 korrik 2022. dhe se objekt i çështjes kushtetuese ishte vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të KPK gjer sa me padi paditësi në gjykatën e shkallës së parë kërkon fillimisht shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të paditurit dhe në procedurë të rregulltë me vendim të formës së prerë të anulohen të njëjtit, e po ashtu të anulohet në tërësi procesi i intervistimit si kundër kushtetues dhe kundërligjor dhe çështja të rikthehet tek i paditur nga fillimi i procesit të emërimit të Kryeprokurorit të Republikës së Kosovës. Tutje e citon nenin 28 të LKA, i cili rregullon rastet kur padia i dorëzohet organit tjetër ndërsa në gjykatë arrinë pas afatit për paraqitje të padisë dhe konstaton se, në rastin konkret po që se Institucioni Kushtetues të cilit paditësi i kishte drejtuar kërkesën të njëjtën do ja dërgonte në kompetencë për procedim kësaj gjykate, do të kosiderohej kërkesë e afatshme edhe po të arrinte në gjykatë pas afatit ligjor. Po ashtu pretendimet për kthim në gjendjen e më parme të kësaj çështje i vlerëson se nuk i përgjigjen rasteve të përcaktuara me dispozitat e nenit 129 dhe 130 të LPK, pasi që kthimi në gjendjen e më parme bëhet në rastet kur është filluar procedimi gjyqësor dhe gjatë procedurës pala për shkaqe të justifikueshme e ka humbur afatin për kryrjen e ndonjë veprimi procedural, gjer sa në çështjen konkret paditësi në gjykatë ka dorëzuar padinë dhe kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimeve të KPK dhe gjykata ende nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim procedural në ndonjë afat ligjor apo gjyqësor. Nga aryet si më lartë dhe të tjerat si në aktvendimin e saj gjykata e shkallës së parë, bazuar në nenin 34 par.1, nën par. 1.1, lidhur me nenin 27 par. 1 dhe 2 të LKA, padinë e paditësit e hedhë poshtë si të paraqitur pas kalimit të afatit ligjor si në dispozitiv të aktvendimit.

Gjykata e Apelit në procedurë ankimore pasi bënë vlerësimin e pretendimeve të paditësit, si në kuptim të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenet 140,194 195 200,208 dhe 209 të LPK-së, ( ligj i aplikueshëm në kuptim të nenit 63 të LKA-së), me aktvendimin e kontestuar me kërkesë, e refuzohen ankesën e paditësit si e pa bazuar. Në arsyetim pasi bën përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë dhe dispozitave ligjore, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor me hedhjen poshtë të padisë nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit në rastin konkret nuk është plotësuar kushti procedural që i referohet afatit për inicimin e konfliktit administrativ ashtu si është përcaktuar me nenin 27.1, të LKA. Tutje njëjtë si gjykata e shkallës së parë, vlerëson procedurën e ndjekur nga paditësi i cili kundër vendimeve të lartë cekura të kontestuara me padi të KPK, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe pas vendosjes me aktvendimin nr. Ref. RK 2027/22, për pa pranueshmëri të kërkesës, me datë 28.07.2022, ushtron padi në Gjykatën e shkallës së parë ,duke e lëshuar afatin prej 30 ditë ashtu si kërkohet sipas nenin 27, të LKA. Pretendimet e paditësit në ankesë lidhur dërgimin e padisë në Gjykatë Kushtetuese e jo në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e ka bërë duke u bazuar në praktiken e krijuar në rastet e tjera e cila ka vendosur sipas aktgjykimeve të saj në tri raste, pa u dërguar çështja paraprakisht në gjykatë kompetente, i vlerëson si jo të bazuara për faktin se paditësi ka bërë lëshim të hapur me drejtimin e padisë në organin jo kompetent për të vlerësuar aktet përfundimtare administrative të nxjerrë në organin administrativ, kjo për faktin se paditësi dhe i autorizuari i tij kanë arsimim të duhur ligjor dhe se rendi juridik është ndërtuar në mbi bazën e ligjeve e jo të precedentit gjyqësor, se sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë, Gjykata Themelore Departamenti për Çështje administrative është kompetentë për të vlerësuar sipas padisë ligjshmërinë a akteve përfundimtare të nxjerrë në

procedurë administrative. Po ashtu pretendimet lidhur me kthimin në gjendjen e më parme i refuzon si jo të bazuara sepse kjo çështje nuk i referohet rasteve të përcaktuara ashtu si parashihet në nenin 129 dhe 130 të LPK, duke dhënë arsye të njëjta si gjykata e shkallës së parë.

Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes e pranon në tërësi së të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë, me refuzimin si të pa bazuar të ankesës së paditësit dhe vërtetimin e aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë. Aktvendimet kontestuar, të gjykatave të instancave më të ulëta nuk janë të përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës dhe as me shkelje të së drejtës materiale ashtu si pretendon paditësi në kërkesë. Gjykatat e instancave më të ulëta në aktvendimet e kontestuara kanë dhënë arsye të mjaftueshme dhe të bazuara ligjërisht në dispozitat e lartë cekura të LKA dhe LPK, lidhur me vendosjen si në dispozitiv të tyre, kur gjejnë se padia e paditësit është pas afatshme dhe si e tillë hedhet poshtë.

Përfaqësuesi i paditësit në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm e pranon se me datë 28.07.2022 ka ushtruar padi në gjykatën e shkallës së parë por e konteston mënyrën e vendosjes me hedhjen e padisë si jo të drejtë dhe ligjore duke theksuar ndër të tjera se, gjykatat gabimisht kanë zbatuar nenin 27 të LKA, sepse është dashtë të gjej zbatimin nenin 28 par. 2 i LKA-së, rastet kur padia i dorëzohet organit tjetër jo kompetent dhe kur arrin me vonesë në gjykatë kompetente konsiderohet se është paraqit me kohë, nëse kjo ka ndodh për shkak të mos dijes apo gabimit të hapur të paraqitësit, se brenda afatit ligjor 30 ditë ka paraqitur kërkesën në Gjykatën Kushtetuese duke u bazuar në precedentin e saj të krijuar në rastet e tjera si në tri aktgjykimet e saj të theksuar kështu ka fituar të drejtën si parashihet me nenin 31.2, të Kushtetutës për mbrojtjen e barabartë të drejtave në procedurë para gjykatës, se gjykatat e instancave më të ulëta kanë bërë shkelje të dispozitave si më lartë të Ligjit, Kushtetutës dhe parimet ndërkombëtare, duke i mohuar qasje në mbrojtje gjyqësore për një gabim qartazi të hapur dhe duke gjetur mënyra të ndryshme që ti mohohet e drejta në gjykim të drejtë, si dhe theksimet e të tjera në këtë drejtim, kolegji i Gjykatës Supreme, këto pretendime i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se, nuk janë të bazuara në fakte dhe prova ligjërisht të vlefshme, andaj nuk janë me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje, nga ajo e vendosur nga gjykatat e instancave më të ulëta, sepse nga provat dhe faktet e administruara nga gjykatat e instancave më të ulëta dhe theksimeve si më lartë, pa dyshim vërtetohet se paditësi padinë në gjykatën e shkallës së parë e ka paraqitur pas kalimit të afatit ligjor ashtu si parashihet në nenin 27 të LKA i cili është afat prekluziv dhe si i tillë nuk mund të shtyhet. Kundër vendimeve të organit të paditur të dt. 06.04.2022, padi ka paraqitur në Gjykatën e shkallës së parë me datë 28.07.2022. Po ashtu nuk janë të qëndrueshme theksimet e tjera të cekura si më lartë se nga gjykatat më të ulëta është dashtë të aplikohet neni 28 i LKA me që kërkesën e ka dërguar në Gjykatë Kushtetuese brenda afatit prej 30 ditë për tu vlerësuar kushtetutshmëria e vendimeve të organit të paditur duke u bazuar në precedentë të krijuara nga ajo, sepse Gjykata Kushtetuese me aktvendimin e saj Nr. ref.RK.2027/22 të dt.25.07.2022, sipas kërkesës së parashtruar lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të organit të paditur e ka refuzuar si të pa pranueshme dhe pas kësaj paditësi me datë 28 Korrik 2022 ushtron padi në Gjykatë Themelore në konflikt administrativ. Nga këto fakte rezulton se padia nuk është dorëzuar gabimisht në organin tjetër por i është drejtuar dhe dorëzuar së kërkesë Gjykatës Kushtetuese, për vlerësim të kushtetutshmërisë së vendimeve të organit të

paditur të KPK. Kjo kërkesë nuk ka arritur në gjykatën e shkallës së parë pas afatit dhe e pa shqyrtuar për tu nxënë afati si pretendon paditësi dhe për tu trajtuar si padi e po ashtu nuk mund të thirret në fakte se nuk e ka ditur apo se gabimisht e ka paraqitur në Gjykatë Kushtetuese, gjer sa kërkesa i është drejtuar asaj gjykate, pa i shtjerrë mjetet juridike në procedurë të rregullt gjyqësore të konfliktit administrativ me padi për vlerësimin e ligjshmërisë së vendimeve përfundimtare administrative, ashtu si parashihet me dispozitat e cekura të LKA-së.

Pretendimet e tjera si në kërkesë lidhur me rikthimin në gjendjen e më parme ashtu si thekson se janë plotësuar kushtet nga nenin 28 i LKA lidhur me nenin 129 të LPK, që padia të pranohet e afatshme, se në të kundërtën shkelen të drejtat e tij nga neni 4, i LKA, neni 31.2, i Kushtetutës së R. Kosovës dhe nenin 6 i KEDNJ, si e drejtë themelore për një proces të rregullt gjyqësor etj., po ashtu nuk janë të qëndrueshme, sepse në këtë rast gjykatat e themeluara sipas Ligjit për Gjykatat nuk janë kompetente të rivendosin një afat ligjor prekluziv të humbur nga vetë pala paditëse i cili nuk ka vepruar ashtu si parashihet me ligj për të paraqitur padi në Gjykatë Themelore në Procedurë të Konfliktit Administrativ në afatin e lejuar ligjor. Sipas nenit 129 të LPA përcaktohet rivendosja e afateve por vetëm pas fillimit të veprimeve procedurale pas paraqitjes së padisë e tutje, nëse pala nuk shkon në seancë apo e humb afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural. Sipas kësaj dispozite rregullohet kthimi i gjendjes së më parme esencialisht që palës ti lejohet të ndërmarrë ndonjë veprim procedural të cilin nuk e ka ndërmarrë brenda afatit të caktuar ose që palës ti lejohet të marrë pjesë prapë në seancë të re në se ka arsye të bazuara për humbjen e afatit për ndonjë veprim procedural, ligjor apo gjyqësor. Në këto raste gjykata do ti lejoj palës me propozimin e tij të kryej më vonë veprime të caktuara procedurale po që se konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen. Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me situatë të tillë për kthimin e gjendjes së më parme e cila rregullohet sipas këtij instituti ashtu si përcaktohet me nenet 129 -133 të LPK-së, por për padi të paraqitur pas afatit të paraparë ligjor.

Gjykata Supreme i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera të theksua si në kërkesë por i vlerësoi si jo me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje nga ajo e vendosur nga gjykata e instancave më të ulëta. Prandaj mbi këtë gjendje të fakteve si më lartë kolegji i Gjykatës Supreme i vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm vendimet e gjykatave më të ulëta sepse është vërtetuar në mënyrë të plotë çështja në shqyrtim, dhe drejtë kanë aplikuar dispozitat ligjore të Ligjit të Procedurës Administrative, Ligjit për Konflike Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore. Aktvendimet e kontestuara nuk janë të përfshirë me shkelje procedurale apo me zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Aktvendimet e atakuara me kërkesë janë të qartë dhe të arsyetuar mjaftueshëm lidhur me faktet vendimtare, të cilat i aprovon edhe kjo gjykatë.

Nga sa u parashtrua si më lartë dhe në bazë të nenit 54 parag.1, të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME- PRISHTINË  
ARJ nr. 114/2022, me datë 23. 12. 2022.

Procesmbajtës,

Kryetari i Kolegjit,

Numri i lëndës: 2022:153199  
Datë: 27.12.2022  
Numri i dokumentit: 03800241

Sherif Krasniqi

Ragip Namani